



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë

Shërbimi për punë të Kuvendit

01Nr 060-32267 2021

Klinë, me 14.09.2021

-Propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet të ndalura nga Debati me Publikun i mbajtur me datë 13.09.2021

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe konsultimi me publikun lidhur me :

- 1. Draft- Buxheti i Komunës së Klinës 2022-2024**
- 2. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës**

Lidhur me pikën e parë referoi drejtori për Financa Ekonomi dhe Zhvillim z. Aziz Desku, ku prezantoi të dhënat nga draft-buxheti i komunës për vitin 2022-2024 sipas tabelës.

Kategoritë buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	6,460,889	6,493,193	6,525,659
2 Mallra dhe shërbime	1,308,064	1,351,526	1,367,882
3 Komunalit	167,000	171,312	178,165
4 Transfere dhe sub.	350,000	379,296	405,758
5 Kapitale	3,047,380	3,676,638	4,173,052
TOTALI :	11,333,332	12,071,965	12,650,516

-Gjithashtu theksoj se vlera në kategorinë e subvencioneve është rritur nga viti në vit ku nga 68.000.00 euro sa ka qenë në fillim deri në vitin 2024 do të arrij në vlerë prej 405.000.00, ndërsa sa i përket projekteve kapitale, prijnë projektet infrastrukturore rrugë, kanalizim, rregullime të shtretërve të lumenjve etj.

-Sa i përket projekteve infrastrukturore në fshatin Sferk, Volljak, Dush dhe Qupev, kishte propozim që të kishte ndonjë projekt tjetër më me dobi për qytetaret e asaj ane. Por në të njëjtën kohë kishte propozim për investim në infrastrukturë rrugore në fshatin Sferk.

-Po ashtu u propozua që më shumë të ketë furnizim me medikamente në shëndetësi se sa të parashikohen renovime të objekteve shëndetësore.

-Kërkesë nga qytetaret ishte rregullimi i fushës së sportit në fshatin Dush dhe Gllarevë. Nga fshati Shtupel kishte kërkesë për rregullimin e ndriçimit dhe infrastrukturës rrugore, po ashtu kishte kërkesë për rregullimin e rrugës në fshatin Jagod deri tek shkolla.

Pika 2- Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës

-Sa i përket kësaj pike referoj drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjente z. Iber Elezaj i cili theksoj se Asociacioni i Komunave të Kosovës ka përgatitur këtë draft i cili do të jetë unik për të gjitha komunat e Kosovës. Theksoj se kjo rregullore parasheh të gjitha të drejtat për shfrytëzimin e pronës shoqërore deri në një vit.

-Nga publiku u sugjerua që Neni 4. Paragrafi 2. Pika 1.2 parimi i efikasitetit të ndryshohet formulimi, ku thuhet sa më shpejt, të caktohet me ditë.

Poashtu u sugjerua që pika 1.5 të ndryshohet dhe të formulohet kështu:

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të mos ndërhyj në projektin e rritjes së lokalit me qëllim të rritjes së sipërfaqes me të madhe se sa është lëshuar me kontratë.

Gjithashtu tek Neni 5. Paragrafi 2. Pika 2.5 u sugjerua të ndryshohet si në vijim: 2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve, institucioneve shëndetësore dhe private.

Ndërsa Neni 7. Paragrafi 3. sugjerua të jetë si në vijim:

-Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar dhe jo ti ndërrohet destinimi.

